

7 korrik 2021



**Banka e Shqipërisë**  
Departamenti i Politikës Monetare




**Komisioni Evropian<sup>1</sup>**

### Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

*Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)* shënoi një rritje prej 1.6 pikë në muajin qershor 2021 krahasuar me nivelin e muajit maj. TNE-ja vijoi prirjen përmirësuese për të shtatin muaj radhazi. Niveli aktual i treguesit arriti në 105.7, duke qëndruar 5.7 pikë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Dinamika pozitive e TNE-së në muajin qershor u përcaktua kryesisht nga rritja e besimit në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë. Gjithashtu, besimi konsumator u përmirësua por në një masë më të vogël. Nga ana tjetër, besimi në sektorin e industrisë shënoi rënie, ndërsa besimi në sektorin e ndërtimit mbeti në nivel të përafërt me vlerat e muajit të kaluar (Grafik 2).

**Grafik 1.** Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

<sup>1</sup> Vrojtimit e besimit bashkë-financohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian.

**Treguesi i besimit të industrisë (TBI)** ra me 2.1 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar, por jo nën mesataren afatgjatë (Grafik 2). Ky zhvillim u ndikua nga rëniet në komponentët e *kontratave nga eksportet* dhe *prodhimi aktual* (Tabelë 2 - Industria). Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në industri shënoi vlerën 75.9% për tremujorin e dytë të vitit 2021<sup>2</sup>, rreth 1.4 pikë përqindje më e lartë se një tremujor më parë. Përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me tremujorët pararendës shënoi edhe treguesi i *gjendjes financiare* të bizneseve në sektorin e industrisë.

**Treguesi i besimit në ndërtim (TBN)** rezultoi shumë pranë nivelit të muajt të kaluar. Dy komponentët përbërës të tij kanë lëvizur në kahe të kundërta. Vlerësimi i bizneseve në lidhje me *aktivitetin ndërtues* është më i ulët se një muaj më parë, ndërsa komponenti i *porosive aktuale* është përmirësuar (Tabelë 2 - Ndërtimi). Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim shënoi vlerën 66.7% për tremujorin e dytë të vitit, rreth 3.0 pikë përqindje më e lartë se një tremujor më parë.

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve\*.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Shënim: \*Grafiku paraqet seri të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatare dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

**Treguesi i besimit në shërbime (TBSH)** u rrit me 4.1 pikë përqindje në muajin qershor krahasuar me muajin maj. Kjo rritje u ndikua si nga komponenti i lidhur me *ecurinë e biznesit* ashtu edhe nga komponenti i lidhur me *kërkesën*. Për të dytin muaj rresht, ky tregues është mbi nivelin e mesatares së tij afatgjatë (Grafik 2, Tabelë 2 - Shërbime). Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në shërbime shënoi vlerën 75.4% për tremujorin e dytë të vitit, rreth 2.4 pikë përqindje më e lartë se një tremujor më parë. Përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me tremujorët pararendës shënoi edhe treguesi i *gjendjes financiare* të bizneseve në këtë sektor.


**Treguesi i besimit në tregti (TBT)** u rrit me 2.2 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar, duke vijuar të mbetet mbi mesataren e tij afatgjatë. Rritja ka ardhur nga të dy komponentët përbërës të TBT-së - *ecuria aktuale e biznesit* dhe *pritjet për nivelin e punësimit*. Ndërkohë, balanca e *ecurisë së biznesit për tre muajt*

<sup>2</sup> Pyetjet shtesë për bizneset lidhur me *normën e shfrytëzimit të kapaciteteve* dhe *gjendjen financiare* dhe kanë frekuencë tremujore dhe përfshihen në pyetësorët e marsit, qershorit, shtator dhe dhjetorit.

e ardhshëm ka pësuar rënie (Tabelë 2 - Tregtia). Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në tregti shënoi vlerën 74.6% për tremujorin e dytë të vitit, rreth 0.9 pikë përqindje më e lartë se një tremujor më parë .


**Treguesi i besimit konsumator (TBK)** u rrit me 0.4 pikë përqindje në muajin qershor, duke vijuar trendin e muajve të fundit, ndonëse në një masë më të përmbajtur. Rritjen e udhëhoqi pritja pozitive për *situatën e përgjithshme ekonomike në të ardhmen*, shoqëruar nga përmirësime të lehta edhe të pritjeve për *situatën e tyre financiare në të ardhmen* si dhe *pritjet për blerjet në shuma të mëdha*. Nga ana tjetër, komponenti i blerjeve aktuale në shuma të mëdha ka shfaqur rënie krahasuar me majin (Tabelë 2 - Konsumatori).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve gjatë 3 muajve të fundit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë 3 muajve të ardhshëm.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Tabelë 1.** Treguesit e besimit sipas sektorëve\*

	Vlerat			2020			2021			Situata aktuale	
	min	mes	maks	Prill	Maj	Qershor	Prill	Maj	Qershor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-60.5	-12.6	7.6	-57.8	-60.5	-52.6	-8.6	-9.9	-12.1	↓	+
Ndërtim	-57.4	-30.3	-18.5	-51.8	-57.4	-56.3	-15.5	-16.5	-16.6	=	+
Shërbime	-47.4	3.9	23.2	-47.4	-40.5	-40.9	2.3	8.5	12.6	↑	+
Tregti	-32.4	-4.3	9.1	-32.4	-29.4	-27.2	3.5	11.4	13.6	↑	+
Konsumator	-40.6	-24.5	-16.2	-40.6	-36.8	-35.4	-29.1	-26.6	-26.2	↑	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

\*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga maj 2016.

\*\*\*) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

\*\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

**Tabelë 2.** Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2020			2021					
	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shkur	Mars	Prill	Maj	Qersh
<b>INDUSTRIA</b>									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	-17.2	-24.0	-14.5	-16.6	-7.4	5.9	7.2	16.3	14.3
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-22.9	-30.0	-28.7	-24.5	-23.9	-19.6	-16.6	-19.5	-18.3
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-23.5	-37.4	-35.2	-31.5	-34.8	-31.6	-16.5	-26.6	-32.2
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-11.1	-10.2	-10.3	-9.8	-8.6	-6.4	-5.3	1.0	-2.5
Prodhimi pritje (pyetja 5)	30.5	20.5	21.4	24.0	27.5	25.5	28.5	27.0	31.0
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	1.5	2.0	4.4	2.7	5.3	6.3	9.4	7.6	10.7
Punësimi pritje (pyetja 7)	2.2	1.2	-0.5	-2.6	0.9	4.5	3.5	6.8	9.5
<b>NDËRTIMI</b>									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	-21.8	-17.9	-24.7	-11.5	-15.1	-6.9	3.8	10.3	8.4
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-44.7	-46.9	-48.6	-49.6	-43.7	-45.8	-34.7	-43.3	-41.7
Punësimi pritje (pyetja 4)	1.9	2.5	4.6	4.6	1.3	7.3	9.7	7.8	14.8
Çmimet pritje (pyetja 5)	5.9	5.5	5.0	6.0	7.1	10.2	9.4	7.0	10.1
<b>SHËRBIME</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	-2.7	-11.6	-12.6	-14.6	-7.3	-4.4	3.7	10.7	14.3
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	-3.6	-16.6	-14.7	-19.4	-6.0	-10.2	0.9	6.2	11.0
Kërkesa pritje (pyetja 3)	19.8	12.8	11.7	19.6	27.7	26.4	35.2	40.4	34.8
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	-18.8	-7.1	-19.0	-14.8	-12.6	-8.0	-5.4	-5.3	-1.8
Punësimi pritje (pyetja 5)	6.8	4.8	9.1	5.5	9.2	4.1	13.6	11.9	13.2
Çmimet pritje (pyetja 6)	0.2	-0.5	3.1	-6.5	3.0	3.8	2.3	0.4	9.1

<b>TREGTIA</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	-20.1	-16.8	-10.7	-9.1	-0.3	0.5	7.7	19.6	21.8
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	-6.8	-3.9	-5.4	-5.1	-6.4	-4.1	-6.2	-1.1	2.0
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	17.1	16.5	15.5	21.6	21.6	16.8	21.3	29.1	29.0
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	20.5	20.6	18.9	24.0	27.1	24.8	28.1	37.5	32.0
Pritje për ecurinë e biznesit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	-0.6	-2.8	0.7	-0.1	-1.0	-1.5	-0.7	3.1	5.4
<b>KONSUMATORI</b>									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-15.2	-15.6	-15.7	-15.8	-15.0	-17.6	-15.8	-10.1	-12.2
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-1.8	-4.9	-2.3	-0.1	0.8	0.2	1.4	3.4	4.2
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-29.4	-31.1	-27.5	-29.5	-24.3	-26.4	-25.3	-19.9	-19.1
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-8.1	-9.7	-8.2	-5.5	-4.9	-5.2	-0.3	2.3	4.6
Çmimet aktuale (pyetja 5)	0.7	-0.2	-3.6	-6.2	-6.4	-4.5	-5.4	-5.2	-3.1
Çmimet pritje (pyetja 6)	-12.0	-12.0	-14.2	-17.0	-13.8	-15.7	-16.2	-17.3	-19.1
Papunësia pritje (pyetja 7)	21.2	22.9	18.2	19.8	16.9	15.4	10.0	7.7	6.1
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-67.6	-69.6	-70.8	-74.0	-67.5	-66.8	-65.8	-62.9	-64.6
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-57.4	-58.7	-58.6	-56.8	-55.5	-56.4	-51.8	-49.2	-49.1
Kursimi aktual (pyetja 10)	-55.6	-55.0	-54.3	-52.4	-50.0	-51.3	-49.6	-47.2	-46.0
Kursimi pritje (pyetja 11)	-53.2	-55.5	-53.1	-52.4	-49.8	-49.7	-48.4	-45.2	-44.3
Gjendja aktuale financiare (pyetja 12)	-0.7	-0.4	0.5	-0.6	1.1	-0.9	0.8	2.7	2.6

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## **Aneks**

### **Shpjegime metodologjike**

**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vrojtimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE)** ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.